



ODA EKONOMIKE  
E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER  
OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë – KOSOVE

Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299

info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

# Ecuritë ekonomike dhe ambienti për biznes në Republikën e Kosovës

# 2008



Mai 2009, Prishtinë

## SHKURTESAT

OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
MTI	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MTL	Marrëveshja e Tregëtisë së Lirë
ESK	Enti Statistikor I Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DUD	Deklarata Unike Doganore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
NPSH	Ndërmarrjet me Pronësi Shoqërore
NPP	Ndërmarrjet me Pronësi Publike
GDP	Bruto Produkti Vendor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
BB	Banka Botërore
CEFTA	Marrëveshja për Tregëti të Lirë e Vendeve të Europës Qendrore
BE	Bashkësia Europiane

## Përmbajtje

Vështrim hyrës .....	4
I. Ekonomia botërore .....	6
II. Ekonomia e Europës Jug-Lindore .....	7
III. Ekonomia e Republikës së Kosovës .....	10
Zhvillimet karakterizuese .....	10
Struktura e ndërmarrjeve.....	11
Tregu i punës .....	14
Inflacioni .....	16
Tregtia e jashtme .....	17
Sektori financiar.....	23
Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.....	24
Investimet e Jashtme .....	26
IV. Ambienti për biznes .....	27
V. Përmbyllje .....	32

## Vështrimi hyrës

**K**osova, vitin 2008 e filloi me ngjarjen më të ndritur në historinë e saj, kur Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësinë e Republikës së Kosovës më 17 Shkurt 2008. Ndërsa, më 9 Prill 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi dhe më 15 Qershor 2008, hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më sublim për respektim të demokracisë, lirisë dhe të drejtave themelore bazuar në vlerat më civilizuese perëndimore. Me shpalljen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, u vendosën themelet për zhvillim të një shoqërie prosperuese, të qëndrueshme politikisht dhe ekonomikisht me qëllim të integrimi me rajonale dhe evropiane, dhe krijimit të Kosovës si faktor stabiliteti dhe bashkëpunimi në rajon.

Në aspektin ekonomik, ngjarje e rëndësishme ishte mbajtja e Konferencës së Donatorëve në Bruksel dhe zotimet e donatorëve për përkrahje financiare të Kosovës në vlerë prej 1,2 miliard Euro. Poashtu, u inicua anëtarësimi në institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare financiare si në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Parashikimet qeveritare janë që në pranverën e vitit 2009, Kosova do të bëhet anëtare e këtyre dy organizmave tejet të rëndësishëm financiar.

Edhe viti 2008 për Kosovën, ishte vit i sfidës sa i përket shtimit të zhvillimit ekonomik. Këtë sfidë e bëri sidomos të paparashikueshme edhe kriza financiare dhe ekonomike globale që tronditi ekonominë botërore. Kjo krizë u reflektua sidomos në shtetet më të industrializuara, duke mos lënë anash as shtetet në zhvillim. Fatmirësisht, kriza nuk u reflektua me pasojat siq u reflektua te shtetet e zhvilluara, për shkak të zhvillimit më të dobët ekonomik të Kosovës dhe lidhjeve të dobëta me tregjet e kapitalit. Megjithatë, përkundër ruajtjes së sistemit bankar nga kriza për shkak të moszhvillimit të avansuar, kriza financiare nuk la pa dëmtuar sistemin financiar në Kosovë ku deri në fund të vitit 2008 vlera e aksioneve të Trustit Pensional të Kursimeve të Kosovës përkatësisht kontribuesve pensional shënoi rënie në vlerë prej rreth 100 milion Euro, që për rrethanat ekonomike kosovare paraqet goditje të madhe.

Kriza, poashtu u reflektua edhe në zvogëlimin e përqindjes së remitancave dërguar në Kosovë, dhe poashtu, u prek edhe eksporti i Kosovës për shkak të lëvizjes së cmimeve në tregjet e kapitalit.

Në aspektin e krijimit të një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e biznesit, faktor pozitiv ishte inicimi dhe pranimi i kërkesave të OEK-ut dhe të komunitetit të biznesit për reformim të politikës fiskale. Kështu, qeveria dhe Kuvendi aprovuan ndryshimet e politikës fiskale që hyn në fuqi nga 01 Janari 2009.

Poashtu, zhvillime pozitive u ndërmorrën edhe në aspektin e rregullimit të infrastrukturës rrugore, ku filloi modernizimi i rrugëve dhe investimet kapitale në këtë fushë u ngritën.

Një sektor tjetër me zhvillime pozitive konsiderohet edhe fusha e arsimit, me fillimin e reformave të caktuara, ku vlen të përmendet fillimi i akreditimit të universiteteve që operojnë në Kosovë. Këtij, sektori duhet kushtuar vëmendje edhe më të madhe në perspektivë, për shkak se paraqet bazën për krijimin e kadrove profesionale të tregut të punës, që do të bartnin barrën e zhvillimit ekonomik në të ardhmen.

Shkalla e shtimit ekonomik sipas burimeve qeveritare ishte më i madh se në vitet paraprake, mirëpo edhe më tutje brenga më e madhe për pengesat që dalin në këtë rrugëtim mbesin gjendja e

paqëndrueshme energjetike, deficitit tepër i lartë i bilancit tregtar, papunësia e lartë, ekonomia informale dhe sundimi i ligjit.

Kosova për dallim nga shtetet në rajon dhe më gjerë nuk përdor instrumente tregtare për mbrojtjen apo për stimulimin e produkteve vendore që ka efekt direkt negativ në nivelin e deficitit tregtar. Prandaj, edhe liberalizimi tej mase i qarkullimit të lirë tregtar po i kushton ekonomisë sonë sepse mungojnë veprimet dhe sjellja e njëjtë e vendeve në rajon.

Inflacioni përkatësisht ngritja e cmimeve, krahasuar me trendet në vitet paraprake ishte faktor mjaft negativ që pati impakt negativ në rënien e fuqisë blerëse të konsumatorëve kosovar

Procesi i privatizimit edhe pse në procesin përfundimtar megjithatë në vitin 2008 u përcjell me ngecje të procedimit, ku faktor i rëndësishëm ishte periudha e gjatë e transferimit të Agjencionit në kuadër të qeverisë.

Integrimi rajonal CEFTA përkundër shtimit të vëllimit të qarkullimit tregtar reflektoi kah fundi i vitit barrierat jo-tarifore të vendosura nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina lidhur me eksportin e mallrave kosovare në këto tregje. Përkundër kësaj dhe përkundër kërkesave që të përdoren masat e reciprocitetit edhe për mallrat që importohen nga këto dy vende fqinje në Kosovë, megjithatë zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe eliminimi i kësaj bllokade u shtrua në rrugë institucionale duke kërkuar që organet e CEFTA-së të zgjedhin këtë bllokadë me karakter politik.

# I. Ekonomia Botërore

Periodha e viteve 2004-2007, kur GDP-ja globale në mesataren vjetore kishte shtim përafërsisht 5% në vit, nga perspektiva e sotme duket si dicka e largët. Rritja ekonomike në shumicën e vendeve u ngadalësua në gjysmën e parë të vitit 2008, pjesërisht për shkak të shtrëngimeve monetare, rritjes së cmimeve të paparashikueshme të energjisë dhe dislokimeve të tregjeve kreditore. Sidoqoftë, aktiviteti ekonomik global u përkeqësua edhe më tepër në kuartalin e katërt pas përkeqësimit të tregjeve kreditore dhe dështimit të Lehman Brothers. Prodhimi industrial në vendet e OECD-së (tridhjetë ekonomitë më të zhvilluara në botë) në Nëntor ra 7.6%, që ishte rënia më e madhe që nga viti 1975.

Parashikohet që GDP-ja globale të bjerë në vitin 2008 në 0.3%. Kriza ekonomike dhe recesioni i goditi më së tepërmi vendet më të industrializuara, duke mos lënë mënjanë edhe ekonomitë e vendeve të Evropës Jug-lindore, ku një numër i vendeve të prekura nga kriza financiare dhe ekonomike ju drejtuan FMN-së për përkrahje financiare.

Vende të ndryshme ndërmorrën veprime konkrete varësisht nga natyra e krizës. Disa mbështetën sistemet e tyre financiare, ku kthimi në normalitet është shumë i vështirë për shkak të dimenzioneve të mëdha negative që pësuan dhe vështirësive në kthimin e besimit ndaj sistemeve financiare.

Disa qeveri përpiqen të stimulojnë ekonomitë e tyre nëpërmes politikave ekspansioniste makroekonomike. Parashihet që kamatat më të ulëta dhe stimulimi fiskal mund të ndikojnë në stabilizimin e aktiviteteve ekonomike në të ardhmen. Fund viti 2010 ose fillim viti 2011 pritet të jetë periudha kur ekonomitë botërore do të duhej të stabilizohen, me kusht apo me supozimin që krijuesit e politikave do të ndërmarrin hapa adekuat për të parandaluar rikthimin apo vazhdimin e krizës financiare globale.

Ekonomia e SHBA-ve e cila ishte në recesion që nga Dhjetori i vitit 2007, pritet të vazhdojë me rënie deri në fund të vitit 2009, ndërsa në vitin 2010 pritet një rritje reale shumë e vogël e GDP-së, krahasuar me rritjen vjetore ekonomike prej 3% mesatarisht, që ishte gjatë periudhës ndërmjet viteve 1992 dhe 2007.

Nëpër recesione të thella kanë kaluar edhe Kanada, Euro-zona dhe Britania e Madhe. Me një rënie prej 2 deri 4%, që konsiderohen recesione të thella. Ekonomia e Japonisë ka rënë aq shumë në kuartalin e katërt sa që disa e kanë quajtur si depresion gjendjen e ekonomisë japoneze.

<sup>1</sup> EU Candidate and Pre-accession Countries, Economic Quarterly, 9 Janar 2009

## II. Evropa dhe Evropa Jug-lindore

Vala e parë goditëse nga krizat financiare dhe ekonomike ndërkombëtare prekën vendet kandidatë për BE, dhe kandidatët potencial gjatë kuartalit të tretë dhe të katërt të vitit 2008. Rritja e GDP-së vazhdoi të ngadalësohet shumë në kuartalin e tretë për shkak të kërkesës më të ulët vendore dhe të jashtme. Në Kroaci rritja u ngadalësu në 1.6% nga 3.4% në Kuartalin e II dhe 5.6% në 2007, kryesisht për shkak të konsumit më të ulët. Në Turqi në njërin nga vendet më të prekura, rritja e GDP-së ishte vetëm 0.5% në kuartalin e III krahasuar me 2.3% të kuartalit të II ose 4.6% të vitit 2007<sup>1</sup>.

Ngadalësimi i ekonomisë botërore, vecanërisht në BE, tregu kryesor eksportues i tyre, ka dëmtuar kërkesën në disa sektor të rëndësishëm për eksport, siq janë industria e celikut dhe prodhimit të automjeteve. Prandaj, Turqia mund të përjetoj rritje negative të GDP-së.

Aktiviteti i ngadalësuar i kombinuar me cmime më të ulëta të energjisë dhe të ushqimit shpjen në rënie të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deri në fund të kuartalit të III, deficitet e llogarisë rrjedhëse mbetën të larta, duke filluar nga 6% të GDP-së në Turqi deri në 35.4% të GDP-së në Mal të Zi. Mirëpo, në kuartalin e IV p.sh. bilanci tregtar në B&H u përmirësu për herë të parë në dy vitet e fundit.

Në Turqi, importet po zvogëlohen gradualisht dhe deficitet vijues tregtar pritet të ndryshoj në vitet e ardhshme. Sa i përket aspektit financiar, struktura e të hyrave kapitale është rregulluar, sidomos në Kroaci, Turqi dhe Serbi, për shkak të rënies së IHD (Investimeve të Huaja Direkte) dhe rritjes së borxhit të jashtëm, sidomos në sektorin jobankar.

Vazhdimi i rënies së cmimeve të prodhimeve të bujqësisë dhe të energjisë që prej Korrikut, rezultoi me uljen e inflacionit nga numri dyshifror në disa vende deri te nivelet mesatare.

Shkalla e papunësisë deri në kuartalin e III kishte trend zbritjeje, mirëpo kriza ekonomike filloi të shprehet edhe në këtë aspekt në periudhën e fundit të vitit.

Në Tetor, disa vende u ballafaquan me krizën e besimit në sistemin bankar ku depozitorët tërheqnin shumën substanciale të mjeteve (B&H, Serbi, Mal të Zi), por kjo krizë u menaxhua mirë.

Pra, kriza ekonomike globale filloi të prek edhe në vendet kandidatë për BE dhe vendet kandidatë potenciale. Tani është e qartë që shumica e vendeve do të përjetojnë ngadalësim të rritjes në të ardhmen e afërt, si rezultat i kërkesës më të ulët dhe burimeve më të pakta të financimit, sidomos IHD dhe kredi.

<sup>1</sup> EU Candidate and Pre-accession Countries, Economic Quarterly, 9 Janar 2009

## Vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë: Pasqyrë përmbljedhëse<sup>2</sup>

### Bruto Prodhimi Shoqëror (në terma real, ndryshimet vjetore në %)

	'04	'05	'06	'07	'08	Q2/08	Q3/08	Q4/08	Tet08	Nent08	Dhj08
Kroacia	4.3	4.3	4.8	5.6	:	3.4	1.6				
Ish R. Jug. Maqedonise	4.1	4.1	3.9	5.0	:	6.2	5.5				
Turqia	9.4	8.4	6.9	4.6	:	2.3	0.5				
Shqipëria	5.7	5.7	5.5	6.0							
Bosnja e Hercegovina	6.3	3.9	6.7	6.8							
Mali i Zi	4.4	4.2	8.6	10.7		8.0	8.0				
Serbia	8.2	6.0	5.6	7.1		6.3	4.9				
Kosova	3.4	3.9	4.0	4.1							

### Papunësia (në % të fuqisë punëtore)

Kroacia	:	:	:	9.6		13.2	12.4		12.9	13.2	
Ish R. Jug. Maqedonise	37.2	37.3	36.0	34.9		33.8	33.0				
Turqia	10.3	10.2	9.9	9.9		8.9	9.8				
Shqipëria	14.7	14.3	13.9	13.4	:	13.0	12.6				
Bosnja e Hercegovina	43.1	44.7	44.2	42.9	:	41.0	40.5		40.3		
Mali i Zi	22.3	18.5	14.7	11.9	10.7	11.0	10.7	10.7	10.7	10.8	10.7
Serbia	19.5	21.8	21.6	18.8	:	13.0	12.5		12.2	12.6	
Kosova	39.7	41.4	44.9	43.0	:						

### Gjendja e Llogarisë Rrjedhëse (% e GDP-së)

Kroacia	-5.2	-6.4	-7.9	-8.7		-10.6	-12.3				
Ish R. Jug. Maqedonise	-8.4	-2.6	-0.9	-3.0		-11.1	-12.9				
Turqia	-3.6	-4.6	-6.1	-5.8		-6.2	-6.0				
Shqipëria	-5.8	-8.9	-6.5	-10.5		-12.6	-13.2				
Bosnja e Hercegovina	-16.3	-17.3	-7.8	-12.6							
Mali i Zi	-7.2	-8.5	-24.7	-29.4		-33.9	-35.4				
Serbia	-13.4	-8.3	-9.4	-14.9		-20.7					
Kosova	-13.0	-13.0	-13.6	-17.0							

### Inflacioni (Indeksi i Cimit të Konsumit, ndryshimi vjetor në %)

Kroacia	2.0	3.3	3.2	2.9		6.5	7.4		6.0	4.7	
Ish R. Jug. Maqedonise	-0.4	0.5	3.2	2.3	8.3	9.9	8.4	5.5	7.1	5.2	4.1
Turqia	8.6	8.2	9.6	8.8	10.4	10.3	11.7	10.9	12.0	0.8	10.1
Shqipëria	2.9	2.4	2.4	2.9		4.2	3.0		2.8	2.6	
Bosnja e Hercegovina	0.5	4.3	6.1	1.5		8.4	9.4		7.3	5.5	
Mali i Zi	2.2	2.4	3.0	4.3		10.0	9.2		7.8	6.5	
Serbia	9.8	17.3	12.7	6.8	10.7	11.9	10.7	8.9	10.6	9.2	6.8
Kosova	-1.1	-1.4	0.6	4.4		13.9	9.8		4.5	2.6	

### Bilanci i përgjithshëm qeveritar (% e GDP)

Kroacia	-4.1	-3.8	-2.2	-1.8							
Ish R. Jug. Maqedonise	0.0	0.2	-0.5	0.6		0.2	3.0				
Turqia	-4.5	-0.6	-0.1	-1.2							
Shqipëria	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5							
Bosnja e Hercegovina	1.6	2.4	2.9	1.3							
Mali i Zi	-2.6	-2.3	-2.7	6.4		2.8	4.3				
Serbia	0.9	0.9	-1.6	-2.0		-0.8	-0.3				
Kosova	-4.5	-3.0	2.4	7.1		1.2					

<sup>2</sup> EU Candidate and Pre-accession Countries, Economic Quarterly, 9 Janar 2009

# III. EKONOMIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## Zhvillimet karakterizuese

Vitet 2008 ishte edhe një sfidë për ekonominë kosovare në rrugën e saj të rikonsolidimit drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe kompatible me ligjet e ekonomisë së lirë të tregut. Në këtë rrugëtim pati zhvillime të karakterit pozitiv si dhe të karakterit negativ. Si ecuri pozitive ekonomike konsiderojmë:

- Reformimin e politikës tatimore. Përkundër viteve të mëparshme, kur shtetet në rajon ishin në përparësi në tërheqjen e investitorëve për shkak të normave me të ulëta tatimore, viti 2008 u karakterizua me vendimin për uljen e normave tatimore edhe në Kosovë, që hyri në fuqi që nga 01 Janari 2009
- Konferenca e Donatorëve për Kosovë dhe zotimet e donatorëve për përkrahje financiare të Kosovës në vlerë prej 1,2 miliard Euro
- Vazhdimi i rritjes së depozitëve dhe të kredive në sistemin financiar-bankar,
- Fillimi i punëve në rekonstruktimin e infrastrukturës rrugore
- Puna në reformimin e sistemit arsimor dhe akreditimin e institucioneve universitare

Në anën tjetër, viti 2008 ekonominë e Kosovës e karakterizon me këto zhvillimet negative:

- Humbjet e Trustit Pensional të Kosovës, ku vetëm gjatë vitit 2008 vlera e akcioneve të kontribuesve pensional ra më tepër se 90 milion Euro apo rreth 30%
- deficitin më të lartë tregëtar prej 1,65 miliard euro, përaktësisht mbulimi i importit me eksport me 10%,
- inflacionin i shprehur gjatë vitit 2008 me një mesatare vjetore prej 9.4%
- pengesat për zhvillim të ekonomisë së lirë të tregut dhe mosrespektimi i marrëveshjes CEFTA nga ana e vendeve fqinje, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës
- vazhdon të mbretëroj strukturat e pavolitshme e aktivitetet ekonomike,
- vazhdon të mbretëroj nivelin e lartë të papunësisë, ku rritja e papunësisë nga 324.835 (2006), 334,595 (2007) arrin në 335,942 të papunë, që krahasuar me vitin 2007 papunësia është rritur për 0,4%,
- ngecje në procesin e privatizimit
- ngecje në sektorin e investimeve, sidomos në sektor që mund të nxisin zhvillimin ekonomik dhe të zbusin papunësinë

## Struktura e ndërmarrjeve

Viti 2008 përfundoi me një numër prej 90,929 bizneseve të regjistruara pranë Agjencionit për Regjistrim të Bizneseve. Krahasuar me vitin 2006 kur ishin të regjistruara gjithsej 55,884 ndërmarrje, shihet një shtim të numrit të ndërmarrjeve prej 35,045 ose për 61.5%, ndërsa më datën 10 Mars 2008, kur numri i ndërmarrjeve ishte 62,472 sosh, shihet një shtim prej 28,457 ndërmarrjeve ose për 68.7% më shumë.

Kjo tregon se trendi i regjistrimit të ndërmarrjeve vazhdon me një ritëm të njëjtë edhe pse një përqindje e këtyre ndërmarrjeve nuk janë aktivizuar asnjëherë apo janë aktivizuar përkohësisht.

### Struktura e NVM-ve sipas madhësisë së punëtorëve<sup>3</sup>

Klasifikimi	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	%
Mikrondërmarrje	1 - 9 punëtorë	89 447	98.37
Ndërmarrje e Vogël	10 - 49 punëtorë	1 218	1.34
Ndërmarrje e Mesme	50 - 249 punëtorë	209	0.23
Ndërmarrje e Madhe	250 - ... punëtorë	55	0.06
<b>Gjithsej</b>		<b>90 929</b>	<b>100%</b>

Struktura e ndërmarrjeve të regjistruara pothuajse ngelet e njëjtë me vitet paraprake, ku sa i përket numrit të bizneseve të gjitha janë rritur, ndërsa sa i përket pjesëmarrjes në strukturë mikrondërmarrjet janë rritur pak ndërsa ndërmarrjet e vogla janë zvogëluar. Por, në përgjithësi mund të thuhet se struktura e ndërmarrjeve mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha mbetet e pandryshuar. Edhe më tutje prijnë mikro ndërmarrjet (me 1 deri 9 punëtorë) me një pjesëmarrje prej 98.37% nga totali i ndërmarrjeve të regjistruara.

<sup>3</sup> MTI, Agjencioni për Mbështetje të NVM-ve, Vështrim Statistikor i Sektorit të Ndërmarrjeve, Janar 2009

**Struktura e ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë<sup>4</sup>**

Nr.	Lloji i Pronësisë	Numri i Ndërmarrjeve	Përqindja (%)
1	Biznes Individual	82 846	91.12
2	Ortakëri e përgjithshme	3 002	3.30
3	Ortakëri e kufizuar	89	0.10
4	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar - SHPK	4 250	4.67
5	Shoqëri aksionare	344	0.37
6	Kompani të huaja	282	0.31
7	Ndërmarrje shoqërore	15	0.02
8	Ndërmarrje publike	12	0.01
9	Koprativa bujqësore	57	0.06
10	Ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e AKM-së	32	0.04
<b>Gjithsej:</b>		<b>90 929</b>	<b>100</b>

Nga Tabela e mësipërme, shihet se vazhdon trendi i regjistrimit të bizneseve ku dominon forma e biznesit individual ku më 31 Dhjetor 2008 kishte gjithsej 82,846 ndërmarrje. Megjithatë trendi i regjistrimit të bizneseve në forma tjera, përkatësisht, në formë të SHPK-ve (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) ngelet e pandryshueshme përkundër rekomandimeve të Odës Ekonomike të Kosovës që të kemi një numër më të madh të SHPK-ve, konform Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare. Padyshim, pasiguria afatgjate për të qenë prezent dhe për të mbijetuar në kushtet e tregut afarë sot dominojnë në ekonominë kosovare dhe nevoja e vogël për qeverisje të vërtetë korporative, ka ndikuar që të kemi një numër kaq të madh të ndërmarrjeve të regjistruara në formë të bizneseve individuale.

Tabela tregon se 91.12% të ndërmarrjeve janë të regjistruar si biznese individuale (në vitin 2006 ishin 91.7%), ndërsa 4.67% janë regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në vitin 2006 ishin 4.3%).

**Bizneset sipas rajoneve dhe komunave**

Madhësia e popullsisë rajonale dhe komunale, si duket ka determinuar edhe numrin e bizneseve të regjistruara sipas rajoneve dhe komunave. Të dhënat e regjistrimit për vitin 2008 (shih Tabelën e mëposhtme) tregojnë këtë strukturë:

1. Rajoni i Prishtinës 33,047 ndërmarrje apo 36,3 % e totalit
2. Rajoni i Gjilanit 18,367 apo 20.2 % (ku prin Ferizaji i përcjellur nga Gjilani)
3. Rajoni i Pejës ka të regjistruar 15,781 biznese apo 17.4 % (ku prin Peja e më pas Gjakova)
4. Rajoni i Prizrenit ka gjithsej 13,792 apo 15.2 % të bizneseve
5. Rajoni i Mitrovicës ka numrin më të vogël të bizneseve të regjistruara, gjithsej 9,942 biznese apo 10.9 % .

<sup>4</sup> MTI, Agjencioni për Mbështetje të NVM-ve, Vështrim Statistikor i Sektorit të Ndërmarrjeve, Janar 2009

Numri i bizneseve të regjistruara nëpër Regjione dhe komuna<sup>5</sup>

Regjionet dhe Komunat	Numri i Bizneseve	Përqindja
<b>Kosovë</b>	<b>90929</b>	<b>100.0</b>
<b>Regjioni i Prishtinës</b>	<b>33047</b>	<b>36.3</b>
Prishtinë	21210	23.3
Podujevë	3025	3.3
Glllogoc	2201	2.4
Lipjan	2524	2.8
F. Kosovë	2176	2.4
Shtime	1033	1.1
Obiliq	875	1.0
<b>Regjioni i Gjllanit</b>	<b>18367</b>	<b>20.2</b>
Gjllan	5566	6.1
Ferizaj	6679	7.3
Kamenicë	1630	1.8
Kaçanik	1841	2.0
Viti	2136	2.3
Shtërpce	419	0.5
Novobërdë (Artana)	96	0.1
<b>Regjioni i Pejës</b>	<b>15781</b>	<b>17.4</b>
Pejë	5931	6.5
Gjakovë	5139	5.7
Istog	1699	1.9
Klinë	1638	1.8
Deçan	1374	1.5
<b>Regjioni i Prizrenit</b>	<b>13792</b>	<b>15.2</b>
Prizren	8254	9.1
Sharri	829	0.9
Theranda	1566	1.7
Rahoveci	1800	2.0
Malisheva	1343	1.5
<b>Regjioni i Mitrovicës</b>	<b>9942</b>	<b>10.9</b>
Mitrovicë	4348	4.8
Skenderaj	1532	1.7
Vushtrri	2518	2.8
Leposaviqi	789	0.9
Z. Potok	344	0.4
Zveçan	411	0.5

<sup>5</sup> MTI, Agjencioni për Mbështetje të NVM-ve, Vështrim Statistikor i Sektorit të Ndërmarrjeve, Janar 2009

## Tregu i punës

Papunësia ngel një prej brengave kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova dhe ky është treguesi më i dobët makroekonomik, krahasuar edhe me vendet në rajon. Papunësia e vazhdueshme, një brengë e madhe për ekonominë në Kosovë (vlerësohet në 45%). Papunësia e regjistruar në vitin 2008 përfshin një numër të tërësishëm të punëkërkuësve prej 335,942 vetave, që krahasuar me numrin e tërësishëm të punëkërkuësve prej 334,595 në fund të vitit 2007, është për 0.4% më i lartë se viti 2007.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, jo efektshmëria e procesit të privatizimit, mos krijimi i një klime më të favorshme për biznes dhe niveli i ulët i investimeve të jashtme direkte janë disa faktorë të cilët kanë ndikim në moskrijimin e kapaciteteve shtesë të vendeve të reja të punës. Në anën tjetër, për shkak të popullatës shumë të re të Kosovës numri i personave që hyjnë për cdo vit në tregun e punës është mjaft i madh. Kështu, këta faktorë reflektojnë shtimin e papunësisë dhe pamundësinë e zbutjes së saj.

Për shkak të ndërlikimeve të pakta të ekonomisë kosovare me tregjet të cilat janë prekur nga kriza ekonomike globale, ndikimi i krizës në humbje të vendeve të punës në Kosovë, në vitin 2008, ka munguar për fat. Mirëpo, gjasat janë që efekte negative në një masë të caktuar të shfaqen në vitin 2009, për shkak të recesionit që ka goditur dhe po vazhdon të godet vendet më të industrializuara por edhe ato të rajonit.

Papunësia sa i përket grup-moshave paraqitet kështu: grup-mosha prej 15 - 39 vjet përbëjnë një numër të të papunëve prej 249,653 vetave ose 74.3% të totalit; grup-moshën prej 40-54 vjet e përbëjnë 65,585 veta ose 19.5% dhe grup-moshën mbi 55 vjet e përbëjnë 20,658 veta ose 6.1%.

Sa i përket strukturës kualifikuese, të papunë me Universitet janë 2,953 veta ose 0.9% dhe paraqet kategorinë me përqindjen më të ulët të të papunëve, ndërsa kategoria e të pakualifikuarëve paraqet përqindjen më të madhe të të papunëve që kap numrin prej 200,969 vetave ose 60%.

Papunësia kur vështrohet nga aspekti rajonal apo i komunave të Kosovës paraqitet si në vijim:

1. Prishtina, 64,340 të papunë
2. Mitrovica, 62,816 të papunë,
3. Prizreni, 57,426 të papunë,
4. Gjakova, 40,006 të papunë,
5. Peja, 39,016 të papunë,
6. Gjilani, 36,470 të papunë, dhe
7. Ferizaji, 35,868 të papunë

Por, duke marrë parasysh raportin midis numrit të popullsisë dhe numrit të të papunëve, rrjedh se komuna apo rajoni i Mitrovicës gjendet në një situatë shumë të pafavorshme në krahasim me komunat tjera.

Informatat e Tregut të Punës në Kosovë - Janar, 2009<sup>6</sup>

		01/2009	12/2008	% Ndryshimi te 01/2009	11/2008	% Ndryshimi te 01/2009	Fillimi i 2009	01/2008	% Ndryshimi te 01/2009
Regjistrimi / Personat e papunë		3337017	335942	0.3 %	335581	0.4 %	335942	335732	0.4 %
Femra		158858	158120	0.3 %	157915	0.5 %	158120	157370	0.8 %
Rajonet	Ferizaj	35988	35888	0.3 %	35785	0.6 %	35868	35054	2.6 %
	Gjakovë	40112	40006	0.3 %	39915	0.5 %	40006	39036	2.8 %
	Gjilan	36581	36470	0.3 %	36437	0.4 %	36470	36204	1.0 %
	Mitrovicë	63208	62816	0.6 %	62373	1.3 %	62816	82807	0.6 %
	Pejë	39138	39016	0.3 %	38944	0.5 %	39016	38244	2.3 %
	Prishtinë	64428	64340	0.1 %	64882	-0.7 %	64340	88801	-6.1 %
	Prizren	57582	57426	0.3 %	57245	0.6 %	57426	55786	3.2 %
Grup-mosha	15-24	102088	101658	0.4 %	101327	0.8 %	101658	99331	2.8 %
	Femra	49091	48891	0.4 %	48768	0.7 %	48891	47697	2.9 %
	25-39	148486	147995	0.3 %	147931	0.4 %	147995	147906	0.4 %
	Femra	70877	70639	0.3 %	70570	0.4 %	70639	70387	0.7 %
	40-54	85785	65585	0.3 %	65613	0.3 %	85585	66367	-0.9 %
	Femra	29950	29857	0.3 %	29857	0.3 %	29857	30147	-0.7 %
	55+	20658	20704	-0.2 %	20690	-0.2 %	20704	22128	-6.6 %
Femra	8781	8774	0.1 %	8753	0.3 %	8774	9172	-4.3 %	
P. etnike	Shqiptarë	306470	305433	0.3 %	305081	0.5 %	305433	305518	0.3 %
	Serb	13179	13198	-0.1 %	13212	-0.2 %	13198	13450	-2.0 %
	Minoritetet tjera	17368	17311	0.3 %	17268	0.6 %	17311	16764	3.6 %
	Të gjitha minoritetet	30547	30509	0.1 %	30479	0.2 %	30509	30213	1.1 %
Str. kualifikuese	Të pakualifikuar	201544	200969	0.3 %	200892	0.3 %	200969	200425	0.6 %
	Femra	114043	113802	0.4 %	113527	0.5 %	113802	112877	1.2 %
	Gjysmë të kualif.	13682	13695	-0.1 %	13693	-0.1 %	13695	14013	-2.4 %
	Femra	6420	6424	-0.1 %	6413	0.1 %	6424	6539	-1.8 %
	Të kualifikuar	29081	29025	0.2 %	29235	-0.5 %	29025	29790	-2.4 %
	Femra	4289	4295	-0.1 %	4314	-0.6 %	4295	4489	-4.5 %
	Shkolla e mesme	87515	87087	0.5 %	86644	1.0 %	87087	86544	1.1 %
	Femra	32071	31989	0.3 %	31871	0.6 %	31989	31934	0.4 %
	Shkolla e lartë	2221	2213	0.4 %	2211	0.5 %	2212	2209	0.5 %
	Femra	848	842	0.7 %	840	1.0 %	842	839	1.1 %
	Universiteti	2974	2953	0.7 %	2888	3.0 %	2953	2751	8.1 %
	Femra	1021	1002	1.9 %	983	3.9 %	1002	926	10.4 %
	Personat me aftësi të kufizuar		1821	1814	0.4 %	1818	0.2 %	1814	1730
Femra		708	703	0.7 %	709	-0.1 %	703	670	5.7 %

<sup>6</sup> Informatat e Tregut të Punës në Kosovë, Sektori i Analizave në Tregun e Punës / Departamenti i Punës dhe Punësimit, MPMS

## Inflacioni

Dy vitet e fundit, 2007 dhe 2008, ishin periudhat ku cmimet e konsumit përkatësisht të produkteve dhe shërbimeve në Kosovë pësuan ngritje mjaft të madhe. Derisa indeksi i cmimeve në Kosovë për vitin 2007 tregonte një ngritje mesatare prej 4.3%, viti 2008 reflekton një përkeqësim të këtij treguesi dhe mesatarja e indeksit të cmimeve arrin në 9.4%. Inflacioni më i madh arriti kulminacioni në mesin e vitit 2008.


Pasi që Kosova është një ekonomi ende e pastrukturuar si duhet, dhe që bazohet kryesisht në importin e produkteve dhe shërbimeve, atëhere efektet e rritjes së cmimeve në tregjet e jashtme janë shprehur drejtpërdrejt edhe në ekonominë tonë.

Sikur ekonomia kosovare të kishte kapacitete prodhuese dhe të zëvendësonte një sasi më të madhe të produkteve që importohen me produkte vendore, atëhere mundësia që së paku të amortizohet kjo rritje do të ishte më e madhe.

Inflacioni i lartë dhe pamundësia financiare (e ndikuar nga rrjedhat jo të knaqshme ekonomike) për të ndikuar në ngritjen e pagave dhe të transfereve sociale ka ndikuar që gjendja sociale të përkeqësohet, sidomos e shtresave më të rrezikuara apo më pak të mbrojtura.

### Ndryshimet mujore në përqindje të ICK-së, Maj 2002 - Dhjetor 2008<sup>7</sup>

Ndryshimet mujore në përqindje të ICK-së, Maj 2002 – Dhjetor 2008<sup>1</sup>



<sup>7</sup> ESK, Indeksi i Cmimeve të Konsumit, Dhjetor 2008

## Tregëtia e Jashtme

Qarkullimi tregtar i Kosovës me botën e jashtme gjatë vitit 2008 u rrit dukshëm. Importi total i mallrave arriti shumën prej 1,84 milion euro ndërsa eksporti total arriti vlerën prej 188 milion euro. Eksporti i rregulltë ishte në vlerë prej 88,9 milion euro kurse re-eksporti kapi vlerën prej 95,7 milion euro. Importi u rrit për 22.7% krahasuar me vitin 2007 ndërsa eksporti për 93%. Gjatë vitit 2007 importi kishte një rritje vjetore prej 20.8%, ndërkohë eksportet e mallrave kosovare kishin rritje prej 35.2% në krahasim me vitin 2006 dhe si rrjedhojë, mbulimi i importeve me eksport në vitin 2007 u ngrit në 6.4%, krahasuar me 5.7% të vitit 2006.

Viti 2008 u karakterizua me trendin e rritjes së deficitit tregtar në mallra që arriti në 1,65 milion Euro përkatësisht një shtim të deficitit tregtar prej 17,9% ose 250 milion euro krahasuar me vitin paraprak.

Sa i përket partnerëve të jashtëm me të cilët është zhvilluar tregti më e madhe, Maqedonia prin në strukturën e importit kurse Shqipëria në atë të eksportit. Nga Maqedonia janë importuar 18.6% (në vitin 2007 ishte 15.7%) e mallrave ose 343 milion Euro nga totali i importit, pastaj me rradhë vjen importi nga Serbia që merr pjesë me 11.3% ose në vlerë 208 milion euro. Vendin e tretë e zënë Gjermania me 10.6% ose në vlerë prej 196 milion euro.

Shqipëria zënë vendin e parë në eksportin e mallrave kosovare me 15.6% ose 13.9 milion euro, pastaj vjen Maqedonia me 14.2% ose 12.8 milion euro dhe vendin e tretë e zënë Zvicra me 11.9% të totalit të eksportit ose 10.7 milion euro. Këta tregues kanë të bëjnë me eksportin e rregulltë.

Poqëse krahasojmë vitin 2007 me 2008 sa i përket lëvizjeve rritëse ose rënëse me qarkullim më të madh të eksportit, rezulton se grupi prej 10 vendeve mbeten të njëjta me dallim të ndërrimit të pozicioneve ku Shqipëria dhe Maqedonia e kanë ndërruar vendin e parë dhe të dytë dhe ky ndërrim i pozicioneve vlen edhe për vendet tjera.

Ndërsa sa i përket importit Maqedonia vazhdon të mbajë vendin e parë, e dyta është Serbia dhe e treta Gjermania. Edhe në mesin e 10 vendeve me importin më të madh ka disa ndryshime të pozicioneve dhe poashtu rezulton se në pozitën e 9 renditet Shqipëria e cila një vit më parë nuk gjendej në mesin e 10 vendeve me import më të madh.

## Eksportet dhe struktura e mallrave të eksportuara

Pjesa më e madhe e eksporteve 44.2% (në vitin 2007-42%) përbëhet nga "metalet dhe artikuj metalik" të cilat kapin shumë prej 39.3 milion euro. Produktet minerale të eksportuara përbëjnë 10.9% të totalit të mallrave të eksportuara ndërsa pasojnë ushqimi i përgatitur me 9.95 dhe produktet vegjetale me 9.2%.

Sa i përket destinacionit të mallrave të eksportuara, në vitin 2008 pjesa më e madhe e eksporteve ishte drejtuar kah vendet e CEFTA-së me pjesëmarrje prej 42.7% (viti 2007-49%) ndërsa eksportet në vendet e BE-së përfshijnë 33.5% të totalit të eksportit.

## Importet dhe struktura e mallrave të importuara

Produktet minerale ishin mallrat më të importuara me pjesëmarrje prej 16.6% ose 306 milion euro, ushqimi i përgatitur me 14.2% ose 262 milion euro, makineritë dhe pajisjet elektrike telekomunikuese me 12.8% ose 236 milion euro.

Sa i përket destinacioneve të mallrave të importuara, në vitin 2008 vendet e integritit rajonal CEFTA marrin pjesë në strukturën e tërësishme me 37.6%, ngajshëm me vitin paraprak dhe vendet e BE-së marrin pjesë 37.4%, që poashtu i ngjan qarkullimit të vitit paraprak.

### Treguesit kryesor të tregtisë gjatë vitit 2008<sup>8</sup>

KU KA EKSPORTUAR KOSOVA		
1. Shqipëri	15.6%	13,918
2. Maqedoni	14.2%	12,677
3. Greqi	11.9%	10,666
4. Zvicër	8.24%	7,325
5. Serbi	7.2%	6,464
6. Slloveni	5.9%	5,257
7. Itali	5.5%	4,937
8. Gjermani	4.7%	4,179
9. Bosnje dhe Hercegovinë	4.5%	4,036
10. Bullgaria	1.9%	1,702
Vende të tjera të botës	20%	17,767
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>	<b>88,928</b>

ÇFARË KA EKSPORTUAR KOSOVA		
1. Metale dhe Artikuj Metalik	44.2%	39,305
2. Produkte Minerale	10.9%	9,737
3. Ushqim I përgatitur; Pijet, Alkoolët dhe Uthulltat; Duhani dhe zëvendësuesit	9.9%	8,842
4. Produkte Vegjetale	9.2%	8,184
5. Makineritë dhe pajisjet mekanike; Pajisje elektrike...	6.3%	5,609
6. Lëkurët e papërpunuara dhe gëzofët, artikujt tjerë prej lëkure...	5.4%	4,861
7. Artikuj te ndryshëm të prodhuar	2.5%	2,252
8. artikuj plastik dhe gomë	1.78%	1,581
9. Produkte të industries kimike dhe lidhjeve	1.72%	1,525
10. Produkte druri, qymyri dhe kashte	1.71%	1,516
Eksporte të tjera	6.2%	5,510
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>	<b>88,928</b>

<sup>8</sup> MTI, Ecuria e shkëmbimeve tregtare 2008

Treguesit kryesor të tregtisë gjatë vitit 2008<sup>8</sup>



PREJ NGA KA IMPORTUAR KOSOVA		
1. Maqedonia	18.6%	343,129
2. Serbia	11.3%	208,061
3. Gjermania	10.6%	196,217
4. Turqia	6.8%	125,759
5. Kina	6.4%	119,435
6. Greqia	4.2%	78,071
7. Italia	4.0%	73,541
8. Sllovenia	3.6%	66,625
9. Shqipëria	2.8%	52,636
10. Kroacia	2.7%	49,934
Vende të tjera të botës	29.0%	526,238
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>	<b>1,839,646</b>

ÇFARË KA IMPORTUAR KOSOVA		
1. Produkte Minerale	16.6%	306,134
2. Ushqim i përgatitur; Pijet, Alkoolët dhe Uthulltat; Duhani dhe zëvendësuesit	14.2%	261,674
3. Makineritë dhe pajisjet elektrike telekomunikuese	12.8%	236,405
4. Metale dhe artikuj metalikë	9.5%	176,330
5. Produkte të industries kimike dhe lidhjeve	7.3%	135,778
6. Mjetet transportuese dhe pajisjet për to:	7.1%	130,847
7. Produkte vegjetale	5.6%	102,991
8. Kafshët e gjalla; Produktet nga kafshët	4.6%	85,339
9. Plastikë dhe artikujt prej tyre: Goma dhe artikujt prej saj	4.5%	83,707
10. Artikuj prej guri, allçie, çimentoje, asbesti, mike apo materiale të ngjashme;	3.6%	67,144
Importe të tjera	13.7%	253,293
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>	<b>1,839,646</b>


Tregtia e Kosovës me vendet e CEFTA-së<sup>9</sup>

Importi Nr.sek / HS	Emërtimi	Vlera	Si % e importeve totale nga vendi	Eksporti Nr.sek / HS	Emërtimi	Vlera	Si % e eksporteve totale në vend
5	Produkte minerale	220,918,282	31.90	15	Metale dhe artikuj metalik	13,561,610	35.62
4	Ushqim i përgatitur, pije alk-joalkool dhe duhan	123,425,846	17.82	4	Ushqim i përgatitur, pije alk-joalkool dhe duhan	6,485,537	17.04
15	Metale dhe artikuj metalik	107,655,561	15.55	2	Produkte vegjetale	5,523,899	14.51
6	Produkte të industrisë kimike dhe lidhjeve	53,300,170	7.70	16	Makineri dhe pajisje elektrike-telekomunikuese	3,003,647	7.89
2	Produkte vegjetale	37,204,316	5.37	8	Lëkura dhe artikuj prej lëkure	2,662,624	6.99
13	Artikuj prej guri, allqie, çimento e të ngjashme	31,458,316	4.54	1	Kafshë të gjalla; produkte me origjinë prej kafshëve	1,133,984	2.98
16	Makineri dhe pajisje elektrike-telekomunikuese	31,335,251	4.52	6	Produkte të industrisë kimike dhe lidhjeve	1,084,596	2.85
7	Artikuj plastik dhe gomë	22,566,524	3.26	20	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	922,624	2.42
10	Brumë druri apo materiale të tjera	14,673,980	2.12	5	Produkte minerale	775,287	2.04
3	Vajra dhe dhjarma prej kafshëve apo vegjetale	11,112,487	1.60	10	Brumë druri apo materiale të tjera	763,150	2.00

<sup>9</sup> MTI, Ecuria e shkëmbimeve tregtare 2008



**Tregtia e Kosovës me vendet e BE<sup>10</sup>**



**Tregtia e Kosovës me vendet e BE**



**Tregtia me Maqedoninë**



<sup>10</sup> MTI, Ecuria e shkëmbimeve tregtare 2008

## Tregtia me Serbinë



## Sektori financiar

**K**rizja financiare globale nuk anashkaloi as Kosovën, dhe kjo krizë preku mjaft shumë edhe sistemin financiar në Kosovë. Sistemi financiar i Kosovës pësoi dëme të konsiderueshme, ku vlera e aksioneve të Trustit Pensional të Kursimeve të Kosovës në fund të vitit 2008 ra mbi 30% (nga vlera më e lartë e arritur) ose shprehur në mjete monetare humbjet në këtë periudhë arritën rreth 100 milion Euro, përkatësisht rreth 10% të Buxhetit të Kosovës. Mjetet e Trustit pensional ishin investuar në tregje të ndryshme ndërkombëtare ku crregullimet e tregjeve dhe kriza financiare globale shkaktoi rënie të dukshme të vlerës së këtyre mjeteve.

Në anën tjetër sistemi bankar, fatmirësisht, ende i pazhvilluar në masën që të kyqet në investime më të sofistikuara të produkteve financiare, shpëtoi në valën e parë të goditjes së krizës financiare. Bankat në Kosovë mjetet e tyre i kishin investuar në kredi për biznese dhe kredi konsumuese në Kosovë, ndërsa një pjesë e mjeteve ishin të depozituara në bankat e jashtme për nevojat e tyre për realizimin e transakcioneve të përditshme bankare.

Sektori financiar i Kosovës në masë të madhe dominohet nga bankat komerciale, asetet e të cilave në shtator 2008 përfaqësuan rreth 79% të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër e sektorit përbëhet nga fondet pensionale (rreth 13%), institucionet mikro-financiare (4.5%), kompanitë e sigurimeve (3.4%) dhe ndihmësit financiarë (0.2%).

Asetet e sektorit bankar, gjatë vitit 2008 vazhduan të rriten. Asetet e sektorit bankar kanë arritur nivelin prej 1.7 miliard euro ose 27% më shumë se në vitin paraprak. Asetet janë rritur për 4% krahasuar me kuartalin paraprak 2008. Struktura e aseteve dominohet nga kreditë që përbëjnë rreth 67% të totalit të aseteve dhe përfshin shumën prej 1,15 miliard euro.

Kreditë si pozicioni kryesor i aseteve, përbëhen kryesisht prej kredive për ndërmarrje 77%, ndërsa kredi për qytetarët paraqesin pjesën tjetër prej 23%. Kreditë për qytetarët kanë pjesëmarrje të ultë sepse kamatat për kredi janë të larta dhe poashtu, pagat e tyre janë të vogla.

Sektori ekonomik më i kredituar mbeten shërbimet me 77.0% të totalit të kredive për ndërmarrjet (59.6% të totalit të kredive). Kreditë për industri, ndërtimtari, dhe energji përfaqësojnë rreth 19% të totalit të kredive për ndërmarrje. Sektori më pak i përkrahur ngel bujqësia me mbi 3% të totalit të kredive për ndërmarrjet.

Edhe gjatë vitit 2008, sektori financiar u karakterizua me rritje të nivelit të depozitëve. Niveli i

depozitëve në fund të vitit 2008 arriti në 1.4 miliard euro. Pjesëmarrja në strukturën e depozitëve ngelet e njëjtë, ku familjet (qytetarët) kishin në pronësi rreth 61% të totalit të depozitëve, pastaj ndërmarrjet publike mbanin 18% të totalit të depozitëve ndërsa ndërmarrjet private kishin në pronësi 14% të depozitëve.

Depozitët në sektorin bankar vazhdojnë të mbesin me afat të shkurtër. Struktura e depozitëve gjatë vitit 2008 pësoj një ndryshim të vogël negativ. Depozitët në të pamë marrin pjesë me mbi 34% (rritje e vogël) të totalit të depozitëve, derisa depozitët me afat dhe ata të kursimit përbëjnë pjesën më të madhe të depozitëve prej mbi 65% (rënie e vogël).

Problem kritik për bankat komerciale mund të paraqes likuiditeti, ku vërehet një mospajtim midis afateve të kredive dhe të depozitëve. Menaxhimi jo i mirë i aktivës dhe pasivës së bankave mund të shkaktoj pasoja negative për likuiditetin e sektorit bankar. Kjo e rrit pasigurinë kur të kihet parasysh se Banka Qendrore nuk e ka funksionin për financim të joliquiditetit të bankave në rast nevoje. Mospajtimi më i madh reflektohet tek afatet ku 82% e depozitëve janë me afat më të shkurtër se 1 vit ndërsa 68% e kredive të lejuara janë me afat më të gjatë se 2 vjet.

Niveli i kamatave në kreditë bankare vazhdojnë të konsiderohen si të larta, ku dallimi midis normave pasive dhe aktive sillet rreth 10%, që tregon që ky sektor përkundër rreziqeve që përmban ka një profitabilitet shumë të lartë. Niveli i kamatave nuk pësoj ndryshime në tregun bankar përkundër ndryshimeve në strukturën e bankave, edhe pse për ndryshime eventuale të afektuara nga konkurrenca e re do të duhej të vinte në shprehje viti 2008. Prandaj, lirisht mund të thuhet se viti 2007 sa i përket uljes së normave të kamatave të sektorit bankar tregoi se konkurrenca nuk ka pasur efekt pozitiv.


## Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës

**T**rusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka treguar performancën më të dobët në kuadër të sistemit financiar në Kosovë. Viti 2008 kur është shfaqur kriza financiare globale me rënien më të lartë të vlerës së asetëve në tregjet botërore që nga koha e depresionit ekonomik të viteve 30-ta, për shkak të mjeteve të investuara në këto tregje pësoi rënie të madhe të vlerës së akcioneve të kontribuesve pensional.

Derisa vlera më e lartë e akcioneve ishte arritur në muajin Maj 2007, prej 1.26 euro për njësi në fund të vitit 2008 vlera e akcioneve pësoi rënie në 0.86 euro, që shprehur në përqindje kjo vlerë ka rënë mbi 30%.

Faktor i rëndësishëm negativ ka qenë edhe moszgjedhja e anëtarëve të Bordit të Trustit si përgjegjës për menaxhim me mjetet, nga ana e BQK-së dhe e Kuvendit të Kosovës.

### Mjetet në menaxhim dhe cmimet e akcionit të TKPK-së<sup>11</sup>



<sup>11</sup> Burim: Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës

### 3.9. Investimet e Jashtme

**M**e Ligjin nr. 02/L-33 Per investimet e huaja, Kosova u ofron trajtim të drejtë dhe të barabartë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në Kosovë, mbrojtje dhe siguri të vazhdueshme dhe trajtimi, mbrojtja ose siguria që kërkohet nuk është në asnjë rast më i disfavorshëm se sa ai që garantohet sipas ligjit ndërkombëtar . Investitorët me kete ligj janë te mbrojtur nga nacionalizimi, ekspropriimi dhe e kanë te drejten e bartjes se fitimeve te tyre ne qdo kohe ne vendet prej nga vijne.

Dy nga barrierat më kryesore janë tejkaluar me ndryshimet që kanë ndodhur vitin e kaluar. E para Kosova është shpall shtet i pavarur dhe njohur nga një numër i konsiderueshëm i vendeve botërore, dhe e dyta se është bërë zbritja e shkallëve tatimore në korporatë dhe në të ardhurat individuale. Ekzistojnë vështirësi në identifikimin e saktë të investimeve të huaja në Kosovë, kështuqë statistika të vecanta jepen nga institucione të ndryshme si BQK, ESK, Departamenti Makroekonomik i MEF-it si dhe APIK-u

Investimet gjatë vitit 2008 që mund të veqohen, janë kryer sidomos në sektorin financiar ku këtë vit kanë filluar së funksionuari bankat si BKT dhe TEB Paribas Join venture, pastaj telefonja mobile IPKO, disa kompani më të vogla dhe me më pak investime në lëmin e këshillimeve. Fillimi i investimit sloven në parkun industrial Teknopolis në Shtime, fillimi i investimit të ndërtimit të një kolegji turk në Lypjan, etj.<sup>12</sup>

Sipas një Raporti të publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës, investimet e huaja direkte gjatë vitit 2008 kanë qenë në shumë prej rreth 350 mil. euro, që është një rënie vjetore prej 16.9%, kryesisht si rezultat i stagnimit në procesin e privatizimit.<sup>13</sup>

Problemet të cilat kanë ndikuar në zbehjen e interesimit të investitorëve të huaj janë: problemi me energji elektrike, mosfunksionimi i ligjit, prezenca e ekonomisë informale, procedurat administrative ende mirë të pa definuar lidhur me marrjen e lejes së punës nga ana e kuvendeve komunale, dhe politikat kreditore (kamatat e larta dhe kthimi i menjëhershëm i kredisë).

APIK për vitin 2009 ka paraparë Hartimin e Strategjisë për Promovimin e investimeve dhe IHD ku nëpërmes një dokumenti studimor dhe analitik do të bëhet evaluimi i politikës investive.

<sup>12</sup> APIK, Agjencioni për Promovim të Investimeve të Kosovës

<sup>13</sup> BQK, Funksionet bankare qendrore

## IV. Ambienti për biznes

Duke vlerësuar se kushtet e ofruara për biznes në vitet paraprake ishin jo të favorshme dhe kushte të cilat nuk e bënë ekonominë kosovare joshëse për investime të jashtme, gjatë vitit 2008 disa ministri u motivuan që të ndërmarrin hapa në ndryshimin e gjendjes ekzistuese. Ekonomia vendore zhvillohej ngadalë, me vështirësi dhe klima ekzistuese nuk premtonte ndonjë nxitje më të hovshme. Në anën tjetër, vendet rajonale kishin ndërmarr hapa që të ndryshonin ambientin për biznes dhe të tërheqin investimet e jashtme, dhe në këtë drejtim Kosova ngeci si një vend më pak atraktiv se sa vendet në fqinjësi.

Shtimi i GDP-së ishte i vogël, papunësia e madhe me trend rritës, ekonomia informale ishte në hov, inflacioni gjatë vitit arriti kulmin që prej përfundimit të luftës dhe të gjithë këta indikatorë ishin shenja alarmuese se dicka duhet ndërmarr, sa nuk është bërë tepër vonë.

Në vazhdim do të japim vlerësimet se a kanë ndryshuar pozitivisht apo jo (në krahasim me vitin 2007) disa faktorë bazë që ndikojnë në klimën për zhvillimin normal të biznesit siq janë:

- Energjia
- Politikat fiskale
- Qasja në financa
- Infrastruktura fizike
- Sundimi i ligjit dhe legjislacioni

### Energjia

Sektori energjetik me disa përmirësime të vogla gjatë vitit 2008, pothuajse mbeti i pandryshueshem dhe i paqëndrueshëm. Energjia ishte njëri nga faktorët kryesor i cili ndikoi negativisht në investime më të ulëta në sektorin e prodhimit apo në sektorët të cilët kanë varshmëri të madhe nga energjia elektrike.

Sfida më e madhe pas faktorit të zbatimit të ligjit, në nxitjen e zhvillimit të prodhimit, të zëvendësimit të importit me produkte vendore dhe për krijimin e parakushteve për ngritjen e aftësive konkurruese të produkteve kosovare dhe eksportit në botën e jashtme, mbetet furnizimi i qëndrueshëm dhe me kosto të arsyeshme të energjisë elektrike.

### Infrastruktura fizike

Me ekzistencën e rreth 7,500 km rrugë në Kosovë, ku 650 km janë rrugë urbane, 1,300 km rrugë rajonale dhe 5,600 km të ashtuquajtura rrugë lokale, vendi ynë përkundër pozitës së përshtatshme gjeografike ende nuk ka krijuar infrastrukturë të mirëfilltë konform standardeve evropiane. Infrastruktura ekzistuese nuk zvogëlon kostonë dhe nuk lehtëson transportin e

lëndëve të para dhe mallrave duke pasur parasysh rrugët e ngushta dhe që rrugët e reja nuk kanë treguar kualitetin e duhur. Infrastruktura hekurudhore shtrihet në një linjë prej 334km, ku pjesët e dëmtuara gjatë luftës ende presin përmirësime.

Mungesa e infrastrukturës moderne rrugore, hekurudhës funksionale, ujit, kanalizimeve, impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, internetit, rrjetit kualitativ për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike etj, janë faktorë që i dekurajojnë investitorët për të investuar në Kosovë.

Por, gjatë vitit 2008 u aktivizua puna në ndërtimin e rrugëve moderne në drejtimet Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Aeroport. Filloi një punë e mbarë e cila pritet që të thith investime tjera kapitale të parapara me Buxhetin e Kosovës, për vitin 2009 dhe kështu, Kosova të filloj të krijoj një rrjet më të sigurtë dhe më të lehtë për qarkullim të kapitalit dhe të njerëzve.

## Politika fiskale

Viti 2008 sa i përket ambientit për biznes filloi me disa iniciativa dhe punë konkrete në përmirësimin, përkatësisht ndryshimin e disa rrethanave ekonomike. Kështu, pas një periudhe të gjatë të presioneve dhe kërkesave për reformë të politikës fiskale nga ana e komunitetit të biznesit në krye me OEK-un, qeveria morri vendim që të ndryshojë normat tatimore për korporata, në të ardhura personale dhe TVSH-ne. Poashtu, ndryshoi dhe u plotësua edhe Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si një element shtesë për një klimë më të favorshme.

Pra, në vitin 2008 u morr vendimi për ndryshimin e normave tatimore si në vijim:

- Tatimi në korporata nga 20% në 10%
- Tatimi në të ardhura personale nga 0,5, 10 dhe 20% në 0,4,8 dhe 10%
- TVSH-ja nga 15% në 16%

Normat e reja hynë në fuqi që nga 01 Janari 2009, dhe shpresohet që këto ndryshime do të ndikojnë në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve kosovar, në tërheqjen e investitorëve të rinj dhe gradualisht edhe në mbushjen e buxhetit të Kosovës. Tatimi në të ardhurat personale konsiderohet si tatimi më i ulët në krahasim me të gjitha vendet në rajon.

Poashtu, Ligji mbi Administratën Tatimore dhe procedurat përpos tjerash do të lehtësojë që me rastin e kryerjes së obligimeve tatimore prioritet të ketë shlyerja e borxhit kryesor për dallim nga shlyerja e ndëshkimeve.

## Qasja në Financa

Edhe pse viti 2008 sipas disa parashikimeve, do të duhej të fillonte me uljen e normave kamatore për shkak të konkurrencës bankare, megjithatë kjo nuk ndodhi në praktikë. Përpos kësaj, në pjesën e dytë të vitit filloi edhe kriza financiare globale e cila nuk preku direkt sektorin bankar në Kosovë mirëpo krijoi parakushte që edhe në të ardhmen të vazhdohet me ofrimin e kredive me kushte të njëjta në mos edhe më të pavolitshme.

Kriza financiare dhe ekonomike botërore filloi të godet edhe Kosovën në disa sektorë, dhe biznesi kosovar në të ardhmen mund të ballafaqohet me vështirësi më të mëdha me rastin e qasjes në financa nga bankat komerciale, për shkak të rritjes së pasigurisë në tregjet financiare ndërkombëtare.

Kështu, bizneset kosovare edhe më tutje duhet të llogarisin në kushte jo të favorshme të kreditimit apo të përkrahjes në zhvillimin e bizneseve të tyre.

## Sundimi i ligjit dhe legjislacioni

Përkundër hartimit të shumicës së ligjeve që kryhet në pajtim me standardet, kërkesat dhe legjislacionin evropian - *acqui communautaire*, megjithatë ky sektor vlerësohet si sektori më i dobët, më i brishtë, joefikas dhe me kapacitete të pamjaftueshme profesionale në procesimin e lëndëve kontestimore.

Nëpër gjykata kosovare ekzistojnë më tepër se 200,000 lëndë civile dhe penale të pazgjidhura për një kohë të gjatë. Vonesa në zgjidhjen e lëndëve dhe sidomos, mungesa e zbatimit të ligjit në pajtim me legjislacionin ekzistues paraqet pengesën kryesore për zhvillimi të mirëfilltë dhe normal të aktiviteteve ekonomike dhe në tërheqjen e investitorëve potencial në Kosovë.

Fusha e ekonomisë, gjatë vitit 2008, është pasuruar me ligje të reja dhe me plotësimin e ligjeve ekzistuese të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku më të rëndësishmit janë:

Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Miratimi	Akti & data shpalljes
1	Ligji për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008	03/L-013	15.02.2008	Rreg.UNMIK-2008/13 - 29.02.2008
2	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë	03/L-048	13.03.2008	Dekreti nr. DL-014-2008, datë 15.06.2008
3	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për inspektoratin e punës	03/L-017	29.04.2008	Rreg. UNMIK -2008/34 - 14.06.2008
4	Ligji për Agjencinë Kosovare të privatizimit	03/L-067	21.05.2008	Dekreti nr. DL-023-2008, datë 15.06.2008
5	Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës	03/L-074	05.06.2008	Dekreti nr. DL-028-2008, datë 15.06.2008
6	Ligji për Hekurudhat e Republikës së Kosovës	03/L-076	05.06.2008	Dekreti nr. DL-030-2008, datë 15.06.2008
7	Ligji për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë	03/L-080	13.06.2008	Dekreti nr. DL-032-2008, datë 15.06.2008
8	Ligji për ndryshimin e rreg. së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë	03/L-081	13.06.2008	Dekreti nr. DL-033-2008, datë 15.06.2008
9	Ligji për ndryshimin e Rreg. së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës	03/L-084	13.06.2008	Dekreti nr. DL-036-2008, datë 15.06.2008
10	Ligji për ndryshimin e Rreg. së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.	03/L-085	13.06.2008	Dekreti nr. DL-037-2008, datë 15.06.2008
11	Ligji për Ndërmarrjet Publike	03/L-087	13.06.2008	Dekreti nr. DL-039-2008, datë 15.06.2008
12	Ligji për ndërmjetësim	03/L-057	18.09.2008	Dekreti nr. DL-048-2008, datë 03.10.2008
13	Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve	03/L-004	03.10.2008	Dekreti nr. DL-050-2008, datë 13.10.2008
14	Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	03/L-031	17.10.2008	Dekreti nr. DL-052-2008, datë 06.11.2008
15	Ligji për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14	03/L-106	10.11.2008	Dekreti nr. DL-055-2008, Datë 17.11. 2008
16	Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës	03/L-109	10.11.2008	Dekreti nr. DL-054-2008, Datë 10.11. 2008
17	Ligji për inspektionin bujqësor	03/L-029	20.11.2008	Dekreti nr. DL-065-2008, Datë 13.12. 2008
18	Ligji për Akreditim	03/L-069	20.11.2008	Dekreti nr. DL-067-2008, Datë 13.12. 2008
19	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për admini-stratën tatimore dhe proceduarat	03/L-071	04.12.2008	Dekreti nr. DL-001-2009, datë 19.01.2009
20	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët	03/L-120	12.12.2008	Dekreti nr. DL-075-2008, Datë 30.12. 2008
21	Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës	03/L-121	16.12.2008	Dekreti nr. DL-070-2008, Datë 30.12. 2008
22	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shëndetësi	03/L-124	16.12.2008	Dekreti nr. DL-074-2008, Datë 30.12. 2008
23	Ligji për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike	03/L-027	18.12.2008	Dekreti nr. DL-083-2008, Datë 07.01. 2009
24	Ligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë	03/L-112	18.12.2008	Dekreti nr. DL-077-2008, Datë 30.12. 2008
25	Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave	03/L-113	18.12.2008	Dekreti nr. DL-078-2008, Datë 30.12. 2008
26	Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar	03/L-114	18.12.2008	Dekreti nr. DL-080-2008, Datë 30.12. 2008
27	Ligji për tatimin në të ardhurat individuale	03/L-115	18.12.2008	Dekreti nr. DL-079-2008, Datë 30.12. 2008

## V. Përmbyllje

Pavarësia e Kosovës poashtu do të jetë një faktor bindës për të zhvilluar një ekonomi të qëndrueshme dhe për të nxitur investimet e huaja direkte por edhe ato nga diaspora. Viti 2008 përkundër pritjeve për shtim të investimeve në Kosovë, megjithatë nuk rezultoi pozitivisht. Disa nga arsyt kryesore ishin kriza financiare dhe ekonomike globale, moskrijimi i një klime më të favorshme për biznes, vazhdimi i ngecjeve në procesin e privatizimit, promovimi pamjaftueshëm i ekonomisë kosovare në botë dhe i potencialeve ekzistuese për investime, qasja e shtrenjtë në financa për biznese, ekonomia informale, krimi i organizuar ekonomik në një pjesë të territorit të Kosovës, zbatimi jo i duhur i ligjit etj.

Shtimi ekonomik më i theksuar (burimet qeveritare) gjatë vitit 2008 kryesisht ishte më tepër si rezultat i dinamikës së sektorit privat se sa e ndonjë përkrahje të qeverisë për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e sektorit privat.

Reformat në sistemin fiskal që hyjnë në fuqi më 01 Janar 2009, do të duhej të ishin elemente për inkurajim të investimeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës

Komuniteti i biznesit i cili filloi të nënshtrohet aplikimit të standardeve të ndryshme, si atyre të kualitetit, poashtu edhe atyre të menaxhimit të cilësisë duhet të vazhdoj këtë proces në mënyrë që produktet e Kosovës të marrin më lehtë vizën për të penetruar në tregjet mjaft konkurruese, qoftë rajonale apo edhe më gjerë.

Infrastruktura e transportit ngel njëra prej sfidave elementare për krijim të një ambienti më të volitshëm për zhvillim të bizneseve. Me përfundimin e punëve të autostradës Durrës-Vërmicë, Kosova dhe jo vetëm Kosova do të krijojë një parakusht shumë të rëndësishëm për lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe njerëzve si dhe për zhvillim të përgjithshëm ekonomik. Ky projekt do të jetë monumenti më grandioz qysh prej pavarësimit të Shqipërisë dhe të Kosovës dhe një perpetum mobile në zhvillimin ekonomik të qeniesë sonë.

Sfida më e madhe mbetin zhvillimet në sektorin e energjetikës dhe në luftimin e ekonomisë jo formale, që nënkupton sundimin e ligjit.



**ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE**